- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- 
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

\_\_\_\_\_

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroje ve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Shërbim Ruajtje për 13 vendroje me shërbim 24 orësh (Turn I+II+III)	(36)	(13)	(4.98)	(X)	(X)
2	Shërbim Ruajtje për 6 vendroje me shërbim 12 orë (Turni I-rë (08:00-16:00) +Turni II(16:00-20:00), nga e Hënë - Shtunë)	(36)	(6)	(2.14)	(X)	
3	Shërbim Ruajtje për 8 vendroje me shërbim 8 orë (Turni I-rë (08:00-16:00) nga e Hënë - Shtunë)	(36)	(8)	(1.43)	(X)	

		<b>Oferta Neto ne total</b>
		<b>TVSH (%)</b> (X)
		<b>Oferta total</b> (X)

1. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Shqiptare (lekë)
2. Në çmim duhet të jenë të përfshirë të gjithë detyrimet që parashikon kuadri ligjor.
3. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për 1 roje dhe vëndroje në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore (1 roje dhe 1 vëndroje) të kryerjes së shërbimit.

Dite ne muaj 365/12	24 ore
Paga baze	
Shtesa ne page	
Totali	
Ore pune/muaj	
Paga orare	
Sigurime shoqerore	
Shtesa ne T2	
Shtesa ne T3	
Sistem alarmi	
Fitimi/shpenz administrative etj	

Dite ne muaj 365/12	12 ore
Paga baze	
Shtesa ne page	
Totali	
Ore pune/muaj	
Paga orare	
Sigurime shoqerore	
Shtesa ne T2	
Sistem alarmi	
Fitimi/shpenz administrative etj	

Dite ne muaj 365/12	8 ore
Paga baze	
Shtesa ne page	
Totali	
Ore pune/muaj	
Paga orare	
Sigurime shoqerore	
Kosto totale T1	
Sistem alarmi	
Fitimi/shpenz administrative etj	

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM-së nr.113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore), 2.14 roje për vendrojet me 12 ore shërbim dhe 1.43 roje për vendrojet me 8 ore shërbim. Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
  - Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total.

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

**Shënim:**

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_\_ ( e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Sherbimi do te kryhet per 8 ore me 1.43 roje, 12 ore me 2.14 roje dhe 24 ore me 4.98 roje :**

Shërbimi i ruajtjes fizike:

- Roja duhet te jene te pajisur e mjete mbrojtese, me uniforma dhe dokument identifikimi dhe mjete te tjera llogjistike sic parashikohet nga ligji 75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike” .
- Te ruaj objektin qe i eshte besuar, te ruaje rendin ne to si dhe te siguroje jeten e personelit.
- Per ruajtjen e objekteve te rendesise se vecante, ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme krahu dhe per objektet e tjera me arme brezi, sipas percaktimeve ligjore te ligjit.75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”
- Sherbimi i ruajtjes fizike do te filloje ne oren 08:00 ne mengjes, do te mbaroje ne oren 16:00 per sherbimin 8 ore dhe ne ore 20:00 ne darke per sherbimi 12 oresh. Sherbimi do te ofrohet nga e Hena ne te Shtune.

Shërbimi i ruajtjes me Alarm.

- Sherbimi i ruajtjes me sistem alarmi do te ofrohet nga ora 16:00 deri ne oren 08:00 ne vendet ku sherbimi i ruajtjes fizike do te ofrohet 8 ore dhe nga ora 20:00 deri ne oren 08:00 ne vendet ku sherbimi i ruajtjes fizike do te ofrohet 12 ore, 24 ore ditet e pushimeve dhe festat zyrtare.

---

- Shërbimi i ruajtjes me sistem alarmi do të ofrohet për ambientet e brendshme të objekteve (sensor të brendshëm).

- Do të vendoset të paktën 1 (një) sistem alarmi për çdo objekt.

- Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike, elektronike dhe moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambientin e marrë në sigurim.

- Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe çaktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.

- Shoqëria e Sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie ( pas ardhjes së sinjalit të alarmit në monitor si pasojë e mosvlerësimit dhe vonesës në verifikim për më shumë se 5 minuta)

- Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.

- Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me Radio, me GSM ose me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastier me kod, me sensorë me kabëll ose me wireless.

- Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuara, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit periodik dhe në periudhën e garancisë, do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të jetë i licensuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit si roje i ruajtjes dhe sigurisë fizike ( kopje e licensës).

b) Të reflektojë një sjellje korrekte dhe të respektueshme.

c) Paisja me mjet identifikimit si roje e ruajtjes dhe sigurisë fizike gjatë gjithë kohës së shërbimit duhet të mbahet në vend të dukshëm.

d) Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjësi i kompanisë SHPSF duhet të respektojë rregullat e brendshme të OSSH sh.a.

e) Punonjësi i ofruesit të shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe veprëjë gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga OSSH.

f) Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" të publikuar në fletoren zyrtare date 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.

g) Të ushtrojnë kontrole të herë pas herë në objektin ku kryen shërbimin, për të parandaluar veprimet e kundërligjshme.

h) Për persona të jashtëm që vijnë për probleme pune, duhet të njoftojnë më parë punonjësin që kërkohet dhe me lejën e tij i shoqërojnë tek ai.

i) Të kërkojnë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:** “ Shërbim i ruajtjes dhe sigurise fizike per pronat dhe personelin e OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Fier dhe Vloresi dhe Njesise se Koordinimit Fier dhe Vlore FSHU sh.a Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj

**Afatet e ekzekutimit: 36 ( tridhjetë e gjashtë )muaj**

**Grafiku i ekzekutimit te shërbimit sipas tabelës bashkangjitur sipas zonave perkatese:**

Zona	Objekti	Destinacioni			Vendroje	Lloji i Shërbimit	Tarife sistemi alarmi/muaj
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier zyra zona	Zyra	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier zyra njesia	Zyra	OSSH	1	8 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier magazina	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier magazina 2	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier magazina 3	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier TL	Zyra	OSSH	1	24 ore	Po



OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier TL magazina	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier Nst/Qarr	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier N/S	N/S	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Fier TEC N/S	N/S	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Patos zyra	Zyra	OSSH	1	8 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Ballsh Zyra	Zyra	OSSH	1	8 ore	Po
OSSH	<b>Zona Fier</b>	Roskovec zyra	Zyra	OSSH	1	8 ore	Po
							Po
OSSH	<b>Zona Vlore</b>	Vlore zyra	Zyra	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Vlore</b>	Skele N/S	N/S	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Vlore</b>	Vlore N/S	N/S	OSSH	1	24 ore	Po
OSSH	<b>Zona Vlore</b>	Vlore W/H	W/H	OSSH	1	24 ore	Po
FSHU	<b>Zona Fier</b>	Fier KNK	KNK	FSHU	1	12 ore	Po
FSHU	<b>Zona Fier</b>	Fier KNK 2	KNK	FSHU	1	12 ore	Po
FSHU	<b>Zona Fier</b>	Patos KNK	KNK	FSHU	1	8 ore	Po
FSHU	<b>Zona Fier</b>	Ballsh KNK	KNK	FSHU	1	8 ore	Po
FSHU	<b>Zona Fier</b>	Roskovec Arke	Arke	FSHU	1	8 ore	Po
					5		Po
FSHU	<b>Zona</b>	Vlore KNK	KNK	FSHU	1	12 ore	Po

	Vlore						
FSHU	Zona Vlore	Vlore KNK 2	KNK	FSHU	1	12 ore	Po
FSHU	Zona Vlore	Vlore KNK 3	KNK	FSHU	1	12 ore	Po
FSHU	Zona Vlore	Orikum KNK	KNK	FSHU	1	8 ore	Po
FSHU	Zona Vlore	Himare KNK	KNK	FSHU	1	12 ore	Po

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### 1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

*“Shërbim i ruajtjes dhe sigurise fizike per pronat dhe personelin e OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Fier dhe Vlore si dhe Njesise se Koordinimit Fier dhe Vlore FSHU sh.a Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

#### 2. Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të institucionit.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

#### 3. Detyrat e kontraktorit:

I Kontraktuari ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t’ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t’ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe

---

të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

- Të garantojë mbulimin me sisteme vëzhgimi (sipas përcaktimit të bërë në tabelë) të objekteve dhe aseteve që ruajnë, dhe sisteme sinjalizimi (sipas përcaktimit të bërë në tabelë)

Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendëshme të institucionit
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
- Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjësën e tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente
- Të jetë i paisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qendrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojas, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.

- 
- Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

4.Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas ndarjes ne Shtojcen 6.

Kërkohen punonjës Shërbimi të shpërndarë sipas *Shtojcës 6*.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:Do të bëhet në Vend-Ndodhjen e Vend-rojeve sipas *Shtojcës 6*.

**Çdo punonjës i shërbimit, titullari i subjektit të SHPSF-së, si dhe drejtuesi teknik duhet të kryejnë me përgjegjësi të gjitha detyrat e përcaktuara në ligjin Nr. 75/2014 'Për shërbimin privat të sigurisë fizike'**

## **Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

---

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

---

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9, si dhe dokumentacioni si me poshte:*

1. *Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;*
2. *Çertifikatë e Titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;*
3. *Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;*
4. *Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në baze të Ligjit nr. 75/2014, nënkategoria 1.3.A, për të paktën për jo më pak se 89 punonjës shërbimi gjithësej, nga të cilat 59 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Fier dhe 30 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Vlore;*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **106,310,290( njeqind e gjashte milion e treqind e dhjete e gjashte mijë e gjashteqind e gjashte )** Leke pa tvsh .*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40 % vlerës së fondit të Marrveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

- 
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
  - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, leshuar nga Drejtorite e Vendore të Policisë Fier dhe Vlore, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin Privat të sigurisë fizike" dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë".
  3. Operatori ekonomik të paraqes Vërtetim Performance nga Drejtorite Vendore të Policisë Fier dhe Vlore, leshuar jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave, ku të jepet informacioni si mëposhte:
    - a) Të ketë jo më pak se 89 punonjës shërbimi të certifikuar gjithësej, nga të cilët 59 punonjës shërbimi në DVP Fier dhe 30 punonjës shërbimi në DVP Vlore.
    - b) Të ketë Përgjegjës Shërbimi, jo më pak se 2 (dy), 1 (një) në Qarkun Fier dhe 1 (një) në Qarkun Vlore
    - c) Të ketë Grupe të gatshme punonjesisht për verifikim të sinjaleve të alarmit pranë DVP ku ndodhen objektet ku do kryhet shërbimi
    - d) Të ketë jo më pak se 5 (pese) operator në Qendrat e Kontrollit në Fier dhe Vlore.
    - e) Të ketë Grupe të Gatshme punonjesisht për verifikim të sinjaleve të alarmit në Qarkun Fier dhe Qarkun Vlore
  4. Operatori ekonomik duhet të ketë performance të mirë gjatë ushtrimit të aktivitetit. Nuk duhet të ketë marrë masa administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas përcaktimeve të kreut V, të Ligjit nr.75/2014, si dhe nuk duhet të kenë ngjarje të ndodhura në objektet ku kanë kryer dhe kryejnë shërbime. Për të provuar këtë fakt duhet të paraqes vërtetim/e të lëshuara nga Drejtorite Vendore të Policisë në Qarqet Fier dhe Vlore.
  5. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara elektronikisht nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 89 (tetedhjete e nente) punonjës të siguruar në muajt, 89 (tetedhjete e nente) punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

6. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë

---

19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi ”zonat” ku ndodhen objektet ku kryhet shërbimi.

7. Ofertuesi duhet të disponojë se paku 8 (tete) automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit në pronësi të shoqërisë .

Në rastin kur automjeti është marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontraten noteriale të marrjes me qera, ku të jete përcaktuar afati dhe qelimi i marrjes me qera.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

8. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizën e kostos për ofertën e paraqitur**.  
(Shih Shtojca 1 - Sqarime)

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Sqarim:** Cdo kriter i parashikuar në nenin 26, pikë 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përmbushet nga Operatorët Ekonomik nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Në bazë të nenit 26, pikë 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” (e ndryshuar), “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

---



## Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

